

Shqipëria dhe Serbia kanë hapur një faqe të re në raportet midis tyre, pavarësisht vështirësve dhe mospajtimeve të njohura midis tyre, ka thënë sot kryeministri i Shqipërisë, **Edi Rama**, në një takim me qytetarët e Preshevës, në jug të Serbisë, transmeton rel.

Takimi është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës të këtij qyteti dhe ka pasuar bisedimet që kryeministri shqiptar zhvilloi me zyrtarët lokalë të Preshevës.

“Nuk do të rreshtim duke punuar për rilindjen e Shqipërisë dhe për rilindjen e shqiptarëve kudo që jetojnë”.

“E marr pësipër përgjegjësinë që na takon, të mos lejojmë gjeneratën e re të shqiptarëve, por edhe atë të serbëve, të trashëgojnë traumat dhe pasojat e një konflikti jashtëzakonisht të gjatë”, tha Rama.

Kryeministri i Shqipërisë qëndron në Preshevë, një ditë pas vizitës në Beograd.